



PËRMBAJTJA

Përkushtimi ndaj Tatim-paguesve

- Mbajtja e seminareve
- Futja në funksion E-Deklarimit


Të hyrat Korrik-Shtator 2011

- ATK-ja, shënon rekord të të hyrave
- Të hyrat sipas llojeve të tatimeve

Të tjera;

- Trajtime të stafit të ATK-së
- Shkarkim rekord në numër të deklaratave nga web-faqja

Të hyrat Janar-Shtator sipas llojeve të tatimeve





Administrata Tatimore e Kosovës, në kuadër të planit të punës dhe përmbledhjes së aktiviteteve, pasqyron buletinin tremujor të aktiviteteve, të cilat janë realizuar në periudhën Korrik -Shtator 2011.

Misioni :

- Të shtohet në maksimum përmbushja vullnetare e obligimeve, duke i dhënë përqendrim të plotë legjislacionit dhe rregulloreve tatimore,
- Të ofrojmë shërbime profesionale, transparente dhe efektive për komunitetin e tatimpaguesve, në mënyrë që ata të kuptojnë obligimet e tyre të pagesës së tatimeve, si dhe
- Të sigurojmë zbatim të drejtë dhe të njëjloshëm, si dhe fuqizimin e ligjeve tatimore me qëllim që të mblidhen të hyra për buxhetin e qeverisë në një mënyrë efikase dhe me kosto të ultë.

Drejtori i ATK-së, z. Behxhet Haliti, me bashkëpunëtorët e tij vizitoi zyrat regjionale të ATK-së

Drejtori i përgjithshëm i ATK-së, z. Behxhet Haliti, me bashkëpunëtorët e tij në muajin Korrik, ka zhvilluar vizita në zyrat regjionale të ATK-së.

Qëllimi i këtyre vizitave ishin të arriturat dhe sfidat në gjashtëmujorin e parë, si dhe angazhim i vazhdueshëm me qëllim të ofrimit të shërbimeve kualitative për tatimpaguesit, si dhe përbushjes së objektivave të parashikuara.

Administrata Tatimore e Kosovës, është e përkushtuar në trajtimin e barabartë të të gjithë tatimpaguesve, gjithashtu, ATK-ja është e palëkundur në qëndrimet e saj në zbatimin e plotë të legjislacionit tatimor, në mënyrë që të krijoj kushte më të mira për zhvillimin e biznesit në Kosovë, theksoi drejtori i përgjithshëm z. Behxhet Haliti.

Ndër të tjera, z. Haliti, gjatë këtyre vizitave ka porositur zyrtarët e ATK-së, që të kenë parasysh se efikasiteti dhe angazhimi i pandërprerë, janë mënyrat e vetme, të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt në ndërtimin e shtetit dhe njëherësh në ngritjen e standardeve jetësore të popullit të Kosovës.

Drejtori i ATK-së, z. Haliti, gjatë këtyre vizitave, ka zhvilluar takim me kryetarët e komunave, si dhe drejtuesit e zyrave regjionale të Odës Ekonomike të Kosovës, mes të cilëve është diskutuar

për ngritjen e bashkëpunimit në disa drejtime, me theks të veçantë në pjesën e regjistrimit të barrës tatimore në Zyrën Komonale Kadastrale të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, dhe në zyrat tjera përgjegjëse për regjistrimin e pronës në lidhje me pasurinë e paluajtshme.



Në njërin nga zyrat e Edukimit të Tatimpaguesve, gjatë vizitave në regjionet e ATK-së.

Administrata Tatimore e Kosovës, ka mbajtur seminar me Ndërmarrjet Publike të Republikës së Kosovës

26 Gusht

Administrata Tatimore e Kosovës, ka mbajtur seminar me Ndërmarrjet Publike të Republikës së Kosovës, rreth trajtimit për pranimin e zhvlerësimit të aseteve, procedurat e njohjes së borxhit të keq, si dhe deklarimi i TVSH-së, në shkallë inkasimi.

Nevoja e këtij seminary ka ardhur pas një takimi të mbajtur me Ministrinë e Ekonomisë, pasi që nga NPP-të, janë ngrit tri kërkesa për ATK-në, që kanë të bëjnë me njohjen e TVSH-së, në shkallë inkasimi, borxhet e këqija, si dhe zhvlerësimi sipas vlerësimit të aseteve.

Administrata Tatimore e Kosovës, sa i përket kësaj çështje, ka potencuar se nuk ka nevojë për ndonjë marrëveshje për trajtimin e këtyre rasteve, me ç'rast tri rastet janë të zgjidhura me Legjislacion. Në mënyrë që

NP-të, të përfitojnë lehtësirat e përmendura, ato duhet të përfillin procedurat e parapara me legjislacion.

Në këtë takim drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, z.Behxhet Haliti, tha se ATK-ja, në kuadër të aktiviteteve të saj, çdo herë është e përkushtuar që ti trajtoj në mënyrë të barabartë të gjitha kërkesat, të cilat adresohen nga ana e tatimpaguesve.



Gjatë seminarit me NPP

Administrata Tatimore e Kosovës, çdoherë afër tatimpaguesve

13 Shtator

Administrata Tatimore e Kosovës, është e përkushtuar në trajtimin e barabartë të të gjithë tatimpaguesve, gjithashtu, ATK-ja, është e palëkundur në qëndrimet e saj në zbatimin e plotë të legjislacionit tatimor, në mënyrë që të krijoj kushte më të mira për zhvillimin e biznesit në Kosovë, kështu tha drejtori i përgjithshëm i ATK-së, z.Behxhet Haliti, me rastin e



Gjatë seminarit me tatimpagues

seminarit përmbyllës për çështje tatimore, i cili u mbajt sot në Prishtinë.

Në këtë seminar janë trajtuar temat, si: regjistrimi i mallrave, mallrat pa mbulesë, arkat fiskale, si dhe ngarkesa e kundërt.

Me ç'rast para Tatimpaguesve, u tha se tatimet nuk dëmtojnë apo heqin privilegje, tatimet dhurojnë përfitime, apo krijojnë privilegje në një mënyrë të organizuar dhe efikase, si në arsim, shëndetësi, infrastrukturë, siguri etj.

Seminari me temën: Çështjet tatimore është mbajtur në të gjitha regjionet e Kosovës, ku interesimi i tatimpaguesve pjesëmarrës në këto seminare ishte mjaft i lartë.

Lancimi i E-Deklarimit -EDI



8 Shtator

Gjatë muajit Shtator është lëshuar në përdorim projekti i E-Deklarimit—EDI, i cili u mundëson tatimpaguesve që të deklarojnë në mënyrë elektronike.

Deklarimi elektronik, është një mënyrë moderne (e avancuar), e shpejtë dhe e thjeshtë për të deklaruar tatimin. Ky sistem mundëson dhe krijon një llogari online të tatimpaguesve me ATK-në, ku mund të plotësohen dhe deklarohen deklaratat tatimore, si dhe të kontrollohet historia tatimore e tatimpaguesve.

Pas lancimit të EDI-it, deklarata e parë që është futur në mënyrë elektronike në sistemin e të dhënave të ATK-së, ishte deklarata e TVSH-së, për muajin Gusht.

Fillimisht, për tu testuar ky sistem janë përzgjedhur 5 tatimpagues. Ku për herë të parë në historinë e ATK-së, Limak Limre Kosova Internacional Airport, deklaroi

tatimin në mënyrë elektronike.

E-Deklarimin, do ta përdorin vetëm bizneset që i takojnë Njesisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj-NJTM, vetëm për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH).


Por së shpejti, deri kah fundi i vitit 2011 dhe fillimi i vitit 2012, do të kenë mundësinë e deklarimit elektronik të gjitha bizneset, për të gjitha llojet e tatimeve.



Prezantimi i EDI-t, në konferencën për media

Administrata Tatimore e Kosovës, inkason 194.1 milionë euro


Administrata Tatimore e Kosovës, ka vazhduar edhe më tej me trendin pozitiv të mbledhjes së të hyrave, ku për periudhën Janar - Shtator 2011, janë realizuar të hyra në vlerë prej 194.1 milionë euro, që në krahasim me objektivin e paraparë, janë më tepër për 5.1% ose 9.4 milionë, kurse në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, të hyrat janë më të larta për 22% ose 34.4 milionë.



Grafikoni me të hyrat Janar-Shtator 2011

Të hyrat sipas llojeve të tatimeve Janar-Shtator 2011

Në strukturën e të hyrave sipas llojeve të tatimeve, pjesëmarrje më të madhe kanë të hyrat nga TVSH-ja, me 47.1%, Tatimi në Korporata me 22.4%, Tatimi i mbajtur në Burim me 19.6%, Tatimi për Bizneset Individuale 9.1%, Tatimi në Fitim 0.9%, Pasqyra mujore e mbajtjes në burim dhe pagesës së Tatimit në Interes, dividendë, të drejta pronësore, qira, fitore në lotari dhe lojëra të fatit 0.6%, Tatimi i Paragjykuar 0.2%.



Grafikoni me të hyra sipas llojeve të tatimeve Janar-Shtator 2011

Trajnimi i inspektorëve të rinj

5 Shtator

Me rastin e fillimit të punës së tridhjetekatër inspektorëve të rinj, Administrata Tatimore e Kosovës, ka organizuar trajnime bazike.

Trajnimet do të realizohen për dymbëdhjet muaj, në tri faza të ndara.

Faza e parë është ajo, që do të realizohet në katër muajt e ardhshëm.

Gjithashtu, është përgatitur edhe Doracaku, në mënyrë që të

punësuarit të kenë një qasje sa më adekuate në vizionin dhe misionin e ATK-së.



Trajnimi i inspektorëve të rinj

Shkarkim rekord të deklaratave tatimore nga web-faqja

Misioni i Administratës Tatimore të Kosovës, është ofrimi i shërbimeve profesionale, transparente dhe efektive, andaj është zhvilluar mundësia e shkarkimit elektronik të deklaratave, e cila u mundëson Tatimpaguesve kryerjen e obligimeve që u takon me ligj, në mënyrë shumë të thjeshtë dhe të lehtë.

Bazuar në numrin e deklaratave të shkarkuara për periudhën Janar-Shtator 2011, që është 1.017.003, shihet se është duke u shënuar një rekord, kurse vetëm gjatë periudhës Korrik –Shtator, janë shkarkuar 321,664 deklarata.

Një nga objektivat e ATK-së, të vendosura në Planin Strategjik 2010-2015, është ofrimi i shërbimeve cilësore, me ç'rast mundësohet edhe shkarkimi i deklaratave në mënyrë elektronike.

<http://apps.atk-ks.org/edeclarations/>

Përfundon drafti final për Strategjinë e Përmbushjes 2012-2015

30 Shtator

Pas takimeve të zhvilluara mes ATK-së, Ministrisë së Financave, Doganës së Kosovës, FMN-së, Bankës Botërore, ECLO, USAID, DFID dhe GIZ, për vendosjen e qëllimeve të gjëra për Strategjinë e Përmbushjes për vitin 2012 – 2015, me 30 Shtator, ashtu siç ishte paraparë, është finalizuar drafti final i Strategjisë së Përmbushjes 2012-2015.

Strategjia e Përmbushjes, është faktor i rëndësishëm për përpykjet tona në uljen e mos deklaruësve dhe ndalim deklaruesve, zvogëlimin e evazionit fiskal, hendekut tatimor që ndikojnë direkt në të hyrat tona, dhe në sistemin tonë të përmbushjes vullnetare.

Kjo strategji, ka për orientim shërbimin dhe përkushtimin ndaj të gjithë tatimpaguesve, duke ju ofruar shërbime profesionale, transparente dhe efektive, si dhe zbatimin e drejt dhe të njëjloshëm të ligjeve tatimore, për përmbushjen vullnetare të obligimeve.

Strategjia e Përmbushjes 2012-2015, përqendrohet në segmentimin e tatimpaguesve në përgjithësi, mirëpo fokus të veçantë iu kushton tatimpaguesve, të cilët nuk dëshirojnë t'i përmbushin detyrimet tatimore, në mënyrë që ata të bëhen tatimpagues të rregullt në përmbushjen e detyrimeve që u takojnë me ligj.



Gjatë zhvillimit të takimit me donator

14 Korrik 2011

Misioni :

- Të shtohet në maksimum përmbushja vullnetare e obligimeve, duke i dhënë përqendrim të plotë legjislacionit dhe rregulloreve tatimore,
- Të ofrojmë shërbime profesionale, transparente dhe efektive për komunitetin e tatimpaguesve, në mënyrë që ata të kuptojnë obligimet e tyre të pagesës së tatimeve, si dhe
- Të sigurojmë zbatim të drejtë dhe të njëjlojshëm, si dhe fuqizimin e ligjeve tatimore me qëllim që të mblidhen të hyra për buxhetin e qeverisë, në një mënyrë efikase dhe me kosto të ulët.

www.atk-ks.org

Adresa : Këndi i rrugëve Bill Klinton & Dëshmorët e Kombit

10000 Prishtinë, KOSOVË

Tel & Fax (+ 381 38) 200 250 17 & 200 250 07

E-mail : info@atk-ks.org

Zyra Qendrore: 038/200-250-17

Prishtina-1: 038/200-255-21

Prishtina-2: 038/200-255-17

Pejë: 039/432-812

Gjilan: 0280/326-967

Prizren: 029/244-963

Ferizaj: 0290/321-668

Mitrovicë: 028/590-667

Gjakovë: 0390/330-021